

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK STUDIME MASTER – DREJTIMI PENAL



**VEPRAT PENALE TË VJEDHJEVE TË KRYERA NGA TË MITURIT NË
TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË GJATË PERIUdhËS
2015-2019**

(Punim për Master)

Mentori:

Prof. Dr. Haki Demolli

Kandidati:

Lumnije Kerqeli

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Përmes këtij studimi hulumtohen dhe trajtohen çështjet që lidhen me veprat penale të kryera nga të miturit. Qëllim kryesor është analizimi kritik i nocioneve thelbësore dhe trajtimi i hollësishëm i sanksioneve penale, llojet e tyre, mënyra e vendosjes sipas veprës penale të kryer si dhe nxjerrja në pah e dallimeve të rëndësishme në procedurat dhe shkeljet e bëra nga personat nën moshën madhore. Me anë të këtij punimi synohet të arrihet përmbushja e këtyre objektivave:

- identifikimi dhe analizimi i faktorëve nxitës të kriminalitetit tek të miturit;
- evidentimi i masave të ndërmarra nga ana e shtetit për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit tek të miturit;
- identifikimi i zbrazëtirave ligjore në lidhje me legjislacionin për të miturit delikuent;
- evidentimi i masave që aplikohen nga Gjykata Themelore e Prishtinës për veprat penale të vjedhjes që kryhen nga të miturit;
- identifikimi i veprimeve dhe masave që duhet të ndërmerren nga shteti për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të të miturve.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton masat dhe dënimet të cilat mund tu shqiptohen të miturve në konflikt me ligjin, të cilat janë edhe objekt i këtij punimi në veçanti masat e parapara ndaj të miturve. Në këtë punim janë trajtuar disa çështje kryesore lidhur me këto masa ndaj të miturve si karakteristika të këtyre masave, personat ndaj të cilëve mund të shqiptohen këto masa, kushtet të cilat duhet të plotësohen për shqiptimin e këtyre masave, llojet e këtyre masave, organet përgjegjëse për caktimin e këtyre masave, dhe procedura e shqiptimit të tyre.

